

TEMA

4

KËMBIMI
NDËRKOMBËTAR



Sh.M.Q.Sh.
"SARAJ"-Shkup



Shkolla e mesme e qytetit të Shkupit "Saraj"- Shkup
Средно училиште на град Скопје "Сарај" - Скопје
Secondary school of Skopje "Saraj" - Skopje

Prof. Burhan Muaremi

PËRMBAJTJA E TEMËS:

1. Thelbi i këmbimit ndërkombëtar

2. Zhvillimi i këmbimit ndërkombëtar

2.1. Lëvizja ndërkombëtare e kapitalit

3. Arsyet për këmbimin ndërkombëtar

3.1. Përparësia absolute dhe krahasuese

3.2. Kushtet e këmbimit

4. Përgjegjësitë e tregtisë ndërkombëtare

4.1. Proteksionizmi si faktor i kufizimit të tregtisë së lirë

4.2. Organizatat ndërkombëtare të tregtisë dhe marrëveshjet e tregtisë së lirë

5. Valutat, devizat dhe kurset devizore

5.1. Nocioni i valutave dhe devizave

5.2. Nocioni i kursit devizor

5.3. Regjimet e kurseve devizore

QËLLIMET E MËSIMIT

Pas leximit të kësaj teme Ju do të mund:

- të definoni nocionin këmbimi ndërkombëtar;
- të realizoni esencën e këmbimit ndërkombëtar;
- të vlerësoni rolin dhe rëndësinë e këmbimit ndërkombëtar;
- të kuptoni arsyet për paraqitjen e këmbimit ndërkombëtar;
- të njiheni me organizatat e tregtisë së lirë;
- të definoni nocionet valuta, devizat dhe kursi devizor;
- të kuptoni kurset devizore fikse dhe të luha

ESENCA E KËMBIMIT NDËRKOMBËTAR

Nevoja për blerje dhe shfrytëzim të mallrave dhe shërbimeve të shumëllojshme të prodhuara në vende të tjera, imponon mënyra të reja të funksionimit të bashkëpunimit në mes ekonomive nacionale në botë. Intensifikimi i këmbimit ndërkombëtar është shkaktuar nga disa faktorë:

- Ndryshimi i mënyrës së jetesës së njerëzve;
- Ndryshimi i kushteve të veprimit të ndërmarrjeve;
- Zhvillimi i teknikës dhe teknologjisë;
- Zhvillimi dhe shpejtësia e këmbimit të informatave, etj.

Të gjithë këta faktorë kanë mundësuar prodhimin e produkte në sasi të mëdha, e me këtë është krijuar nevoja për zgjerim dhe për kapërcim në kuadrot lokale të tregut. Kompanitë, të ballafaquara me kufizim të tregut të vendit për absorbimin e prodhimet e tyre hyjnë në kërkim të klientëve të rinj. Duke përdorur të mirat e teknikës, teknologjisë dhe komunikimit, ata tentojnë të ofrojnë dhe të shesin produktet e tyre në tregjet në botë.

Njerëzit preferojnë të përdorin produkte me cilësi të lartë të prodhuara nga ndërmarrjet e vendeve të tjera, për shembull, të veshin rroba sportive “NIKE”, të vozitin automobilin “BMW“, të pinë “Coca Cola“, etj. Ndërmarrjet nga Kina hapin ndërmarrje prodhuese në Evropë. Bankat e SHBA hapin filiale në Evropë. Investitorët gjermanë blejnë aksione të bursave në Çeki dhe Hungari. Turistët nga vende të ndryshme vazhdimisht shkojnë përmes destinacioneve të famshme dimërore dhe verore turistike, i vizitojnë monumentet historike, i njohin karakteristikat kombëtare të vendeve të tjera etj.

E gjithë kjo tregon në bashkëpunimin gjithnjë e më të madh ndërkombëtar në planin ekonomik, kulturor dhe politik.

Tregtia ndërkombëtare bëhet kur ndërmarrjet nga vende të ndryshme marrin pjesë në blerjen, shitjen apo këmbimin e prodhimeve.

Ekzistojnë dy kritere me të cilat përcaktohet natyra e këmbimit ndërkombëtar, edhe atë: subjektive dhe objektive.

Sipas kriterit *subjektiv* këmbimi ndërkombëtar konsiderohet ai i cili në kohën e nënshkrimit të kontratës, shitësi i përket një vendi, kurse blerësi i përket vendit tjetër.

Sipas kriterit *objektiv*, këmbimi ndërkombëtar konsiderohet ai për kryerjen e të cilit ka ardhur kalimi i së mirës apo shërbimit nga njëri vend në tjetrin.

Nga aspekti i numrit të vendeve në këmbim ndërkombëtar ai mund të jetë bilateral dhe multilateral.

Këmbimi bilateral është ai këmbim në të cilin marrin pjesë dy vende.

Këmbimi multilateral është ai këmbim në të cilin marrin pjesë tri ose më shumë vende.

Tregtia ndërkombëtare mund të jetë në kuptimin e ngushtë dhe të gjerë. Në një kuptim të ngushtë, tregtia ndërkombëtare e përfshin vetëm këmbimin e mallrave midis dy vendeve apo dy rajoneve, pra importin dhe eksportin e mallrave. Tregtia ndërkombëtare në kuptimin më të gjerë, përveç këmbimit të mallrave (importet dhe eksportet e mallrave), në vetvete përfshin edhe tregtinë me shërbimet (importet dhe eksportet e padukshme), lëvizjen e kapitalit dhe transferimin e informacioneve.

2. ZHVILLIMI I KËMBIMIT NDËRKOMBËTAR

Fillimet e para për këmbim kanë karakter të tregtisë ndërkombëtare. Në kohën më të vjetër këmbimi ishte zhvilluar në mes fiseve të ndryshme të cilat i kanë shkëmbyer tepricat e rastit. Pra, këmbimi i parë nuk ishte këmbim në mes anëtarëve të një fisi, por këmbim në mes njërit dhe fisit tjetër, kjo është tregtia e jashtme.

Me zhvillimin e prodhimit dhe ndarjen gjithnjë e më të madhe të punës, tregtia është zhvilluar gjithnjë e më tepër. Kështu, edhe në kohën e vjetër ka ekzistuar tregtia e zhvilluar midis vendeve rreth Mesdheut. Më vonë, pas zbulimit e mëdha gjeografike, tregtia ndërkombëtare bëhej në drejtimin: Evropë-Amerikë dhe Evropë-Azi. Tregtia ndërkombëtare ka përjetuar ekspansion pas Revolucionit Industrial me rritjen e kapitalizmit. Gjegjësisht, rritja e shpejtë e prodhimit industrial çoi në atë se

tregu i vendit të jetë shumë i ngushtë për plasmanin e mallrave. Njëkohësisht, me zhvillimin e mjeteve bartëse u lehtësua transferimi i mallrave në largësi më të mëdha që ka ndikuar pozitivisht në rritjen e shpejtë të tregtisë ndërkombëtare.

Tregtia ndërkombëtare e mallrave dhe shërbimeve në afat të gjatë tregon rritje të vazhdueshme. Kjo tendencë është e shprehur sidomos pas Luftës së Dytë Botërore, kur tregtia botërore u rrit më shpejt se sa rritja e prodhimit botëror. Rritja e tregtisë ndërkombëtare në dekadat e fundit të shekullit të kaluar u zhvillua më shpejt se sa rritja e të ardhurave botërore. Për shembull, në dy dekadat e fundit eksporti botëror u rrit për 8%, pavarësisht nga të ardhurat globale të cilat janë rritur 6%. Në vitin 2000 eksporti mesatar botëror është rritur 11,5% kundrejt rritjes së të ardhurave botërore prej 3,8%.

Pjesëmarrës më të mëdhenj në këmbimin ndërkombëtar janë vendet e industrializuara. Eksportues më të mëdhenj në botë janë: SHBA, Japonia, Gjermania, Franca, Britania e Madhe etj. Këtyre vendeve i takojnë 50%, dhe vetëm SHBA dhe Japonisë i takojnë 24% të eksportit të përgjithshëm botëror.

Këmbimit ndërkombëtar e ndryshon strukturën e vet. Duke filluar prej vitit 1985 e deri më sot, industritë të cilat prodhojnë produkte të teknologjisë së lartë kanë rritje më intensive të eksportit, ndërsa industritë që prodhojnë produkte me një shkallë të ulët të përpunimit shënojnë rritje më të ngadalshme të eksportit. Eksporti botëror i automobilave, kompjuterëve, ilaçeve, pajisjeve shtëpiake e të tjera, në periudhën viteve 1990 - 2000 mesatare është rritur për 14,3%, ndërsa norma mesatare e eksportit të produkteve kryesore si produktet bujqësore, të tekstilit e tjera, është e pandryshuar, kurse te disa produkte edhe negative.

2.1. LËVIZJA NDËRKOMBËTARE E KAPITALIT

Në ekonominë ndërkombëtare, shikuar në afat më të gjatë, pavarësisht nga eksporti i mallrave dhe shërbimeve, rritet rëndësia e rrjedhës së kapitalit ndërkombëtar (eksporti dhe importi i kapitalit). Të dy format më të rëndësishme të eksporteve të kapitalit janë: investimet e huaja direkte dhe investimet portfoile.

Bartësit kryesorë të *investimeve të huaja direkte* në botë janë korporatat transnacionale të cilat i realizojnë investimet e huaja direkte duke hapur kryesisht firma të veta prodhuese – posaçërisht në vende të huaja, duke blerë paketin kontrollues të aksioneve të një kompanie ekzistuese ose ngritjen e një kompanie krejtësisht të re. Korporatat transnacionale përfshijnë firma të mëdha, shumica nga vendet e zhvilluara dhe vendet në zhvillim, dhe kohët e fundit, firmat në ekonomitë e vendeve në tranzicion, si dhe firmat e vogla dhe të mesme.

Investimet e huaja direkte paraqesin formën më të shpejtë të rritëse të lëvizjes ndërkombëtare të kapitalit. Dinamika e rritjes së tyre është shumë më e madhe edhe në ritmin e rritjes së eksporteve dhe importeve botërore⁴. Ato në botë në mënyrë dominuese zhvillohen në relacionin midis vendeve të zhvilluara, në mënyrë që pjesa më e rëndësishme e investimeve të huaja direkte, janë të vendosura tashmë në vendet e industrializuara të botës ekonomike - kryesisht në shtetet anëtare të BE dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Faktorët që i përcaktojnë investimet e huaja direkte janë të shumtë, por më të rëndësishëm janë:

- gjerësia dhe fuqia absolute e ekonomisë së tregut, në të cilën janë bërë investimet e huaja direkte;
- infrastruktura e ndërtimit të vendit;
- faktorët e lirë në dispozicion të prodhimit (të forcës së punës, tokës, lëndëve të para, energjisë dhe inputeve të tjera);
- atmosfera miqësore dhe trajtimi i favorshëm për investitorët e huaj;
- stabiliteti politik i vendit, respektivisht mungesa e rreziqeve jokomerciale etj.

Këta faktorë, nëse ekzistojnë në një vend, atë e bëjnë tërheqës për investimet e huaja direkte, sepse mundësojnë një shkallë të lartë të shtimit të kapitalit.

Në *portofolin e investimeve* përfshihen aksionet e korporatave, përqindja e të cilit është më pak se 10% të numrit të përgjithshëm të aksioneve me të drejta të votimit - të ashtuquajturën equity plasman, investime në bono korporative (bono që janë të emetuara nga ndërmarrjet që të vinë në kapital

⁴€ Fiti „*Makroekonomia*„ - Fakulteti ekonomik, Shkup, 2004 (fq. 270)

shtesë), investimet në bono shtetërore, për çështje të veçanta të bonove (të tilla si eurobono) etj. Për nga investimet e huaja direkte, investimet e portofolit në korporatat nuk janë të drejtuara drejt blerjes së paketit kontrollues të aksioneve, të cilat nuk janë me qëllim majoritetit të kapitalit dhe shoqërisë së huaj të menaxhimit. Si edhe investimet e huaja direkte edhe investimet portofole janë të përfshira në vendet e industrializuara ekonomike me tregje të zhvilluara të kapitalit dhe me një traditë të gjatë në tregtinë me lloje të ndryshme të letrave me vlerë. Që nga vitet nëntëdhjetë e këtej, ekziston një tendencë e rritjes së investimeve të portofolit në vendet në zhvillim dhe vendet në tranzicion, për shkak të faktit se disa vende në zhvillim dhe ekonomitë në tranzicion kanë arritur shkallë të larta të rritjes ekonomike, respektivisht kanë shanse të mira të zhvillimit⁵.

3. ARSYET PËR KËMBIMIN NDËRKOMBËTAR

3.1. VLERA ABSOLUTE DHE KRAHASUESE

Çdo ekonomi kombëtare disponon me burime të kufizuara natyrore, njerëzore dhe burimore të kapitalit që i angazhon të prodhojnë produkte të nevojshme. Shtrirja dhe struktura e burimeve e determinojnë vëllimin dhe strukturën e prodhimit në vend.

Për shkak se burimet janë të pakta dhe të kufizuara, ka nevojë për shfrytëzimin e tyre racional me mundësi që në mënyrë alternative të mund të përdoren, gjë që çon në kategorinë e shpenzimit oportuinent. Shpenzimi oportuinent për prodhimin e një malli ose shërbimi është një mundësi e humbur për përdorimin e mallrave ose shërbimeve që do të prodhohen.

Për shembull, prodhimi e një sasive plotësuese të pajisjes ushtarake në një vend, shkakton shpenzim oportuinent, por ky është rasti i humbur për të prodhuar mallra civile me të njëjtat burime. Nga këtu del edhe baza e paraqitjes së tregtisë ndërkombëtare. Gjegjësisht, në qoftë se një ekonomi e mallrave

⁵E. Fiti „*Makroekonomia*„ - Fakulteti ekonomik, Shkup, 2004